



Planuar / Doretuar Pranëna/Pradato Received/Delivered	08.12.2021	viti god Year	
Organ /Rjesa Organ /Eedmea Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Pilog Appendix	Sasia Kolicana Quantity
SKDPJHCU	5876/2021		1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KESHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.891/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtar dhe Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbaitësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.891/2021 të datës 28.10.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi: Rruga "Rizoni", Nr.41, Komuna Prishtinë, kundër Vendimit Nr.06/2021 të Komisionit të Ankesave për Nëpunësit e Shërbimit Publik të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të datës 08.10.2021, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 08.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet **jo kompetent** për të vendosur për ankesën me numër A.nr.891/2021 të datës 28.10.2021 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesit, marrëveshja e fundit për shërbimeve të veçanta me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit i ka përfunduar me datë 12.10.2019, ndërsa i njëjti me datën 24.05.2021 i ka bërë kërkesë Zëvendës/Sekretarit të Përgjithshëm për informim rreth statusit së tij të punës, ndërsa me datë 03.06.2021 Zëvendëssekretari i Përgjithshëm i është përgjigjur ankuesit në kërkesën e tij se marrëdhënia e tij e punës ka qenë me "Marrëveshje për Shërbime të Veçanta" e cila ka mbaruar dhe për rastet e emërimeve me afate të caktuara nuk kanë asnjë detyrim për vazhdimin e saj.

Ankuesi i pakënaqur me përgjigjen e Zëvendës/Sekretarit të Përgjithshëm me datë 15.06.2021 ka parashtruar ankesë në Komisionin e Ankesave për Nëpunësit e Shërbimit Publik të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, ndërsa me datë 08.10.2021 Komisionit të Ankesave për Nëpunësit e Shërbimit Publik ka nxjerrë vendimin me numër KZKA Nr.06/2021 duke e shpallur veten jo-kompetent.

Ankuesi kundër Vendimit të datës 08.10.2021 të Komisionit të Ankesave për Nëpunësit e Shërbimit Publik të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, më datë 28.10.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 5203/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 01.11.2021 ankesën e ankueses e ka procedura për përgjigje në ankesë tek Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Më datë 05.11.2021 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit më provat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 5203/2021 e datës 28.10.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Marrëveshjen për Shërbime të Veçanta e datës 14.07.2017; Vendimin e datës 27.06.2017 të Sekretarit të Përgjithshëm të MKRS-së; Vendimin e datës 04.10.2017 të Sekretarit të Përgjithshëm të MKRS-së; Marrëveshjen për Shërbime të Veçanta e datës 11.10.2017; Marrëveshjen për Shërbime të Veçanta e datës 13.04.2018; Marrëveshjen për Shërbime të Veçanta e datës 11.10.2018; Marrëveshjen për Shërbime të Veçanta e datës 03.05.2019; Kontratë mbi punën datës 18.01.2016; Pasqyra e llogarisë së trustit të ankuesit për periudhën kohore prej datës 01.01.2019 deri me datë 31.12.2019; Pasqyra e llogarisë së trustit të ankuesit për periudhën kohore prej datës 01.01.2018 deri me datë 31.12.2017; Shkresa e dorëzimit të vendimit e datës 30.01.2018; Vendimin e datës 25.01.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; Ankesën e ankuesit të datës 15.06.2021; Vendimin e datës 08.10.2021 të Komisionit të Ankesave për Nëpunësit e Shërbimit Publik; Kërkesën për përgjigjen në ankesë të datës 01.11.2021; Përgjigjen në kërkesë të datës 05.11.2021; Kërkesën e ankuesit të datës 24.05.2021; Përgjigjen e Zëvendëssekretarit të Përgjithshëm të MKRS-së të datës 03.06.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës **nuk është jo kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit **sepse:**

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, gjatë shqyrtimit të provave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar që ankuesi nga data 03.07.2017 deri me datë 12.10.2019 ka krijuar marrëdhënie kontraktuale me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit përmes pesë (5) Marrëveshjeve për Shërbime të Veçanta të datës 14.07.2017, të datës 09.10.2017, të datës 13.04.2018, të datës 11.10.2018 dhe asaj të datës 03.05.2020 ku asnjëra prej tyre nuk ka qenë me kohëzgjatje me të madhe se gjashtë (6) muaj. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se kategoria e të punësuarve me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta nuk hyn në kategorinë e shërbyesve civil apo të punësuarve në shërbimin civil, pasi që kontratat për shërbimet e veçanta lidhen në bazë të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve siç përcaktohet me dispozitat e nenit 12 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton se: *“Emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtë se gjashtë (6) muaj do të bëhen në bazë të kontratave të quajtura “Marrëveshje për shërbime të veçanta” të cilat i nënshtrohen Ligjit për Detyrime...”*, rrjedhimisht Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka kompetencë që ti shqyrtoj vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për praninë në shërbimin civil, ashtu siç është përcaktuar me nenin 6 paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se: *“Për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, Këshilli ka këto funksione themelore: 1.1. shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për praninë në shërbimin civil”*, andaj mbi këtë bazë Kolegji ka konstatuar se nuk është kompetent për të shqyrtuar ankesën e ankuesit pasi që i njëjti nuk e ka statusin e nëpunësit civil.

Kolegji pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.891/2021

Flakron Gashi

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesi.
- Zv/Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.

